



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 45-të të mbajtur me datë 29.12.2020 morri

VENDIM

Procedura për lëndën me nr. 12-905 nga viti 2020 e formuar në bazë të denoncimit me numër 12- 905/1 me datë 06.02.2020, dorëzuar nga parashtrues nga, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutejshëm për lëndën 12-905 nga viti 2020, në bazë të akuzave të lëndës është duke vepruar organ tjetër kompetent, kurse procedura për lëndër është ndërprerë.

Lënda me numër 12-905 nga viti 2020, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-905 nga viti 2020 e formuar pas denoncimit nr. 12-905/1 me datë 06.02.2020, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga ana e parashtruesit nga

Në denoncimin e dorëzuar janë shprehur akuza për pakënaqsi nga procedura për zgjedhjes së drejtorit organizativ në Institucionin shëndetësis publike Klinika Universitare për Shkup, pas konkursit publik shpallur me datë 02.09.2019.

Gjatë rishikimi të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror i merr paraqsyshë akuzat e parashtruesit në lidhje me akuzat e lëndës dhe për shkak të caktimit të gjendjes së plotë faktike për rastin e lëndës KSHPK dorëzoi kërkesë për të dhëna dhe informacione deri në Ministrinë e shëndetësisë. Pas kërkesës së KSHPK janë dorëzuar të dhënat dh einformacionet dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës, nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për akuza për pakënaqësi nga procedura për zgjedhje të drejtorit organizativ në Institucionin shëndetësis publike Klinika Universitare për Shkup pas konkursit publik shpallur me datë 02.09.2019, gjegjësisht, e njëjta paraqet ankesë të parashtruesit pas lajmërimit nr/.... me datë 16.01.2020 miratuar nga ana e ministrit për shëndetësi të RMV, në të cilën ai, si kandidat i vetëm për drejtor organizativ të këtij institucioni shëndetësor për konkursin publik të lëndës, është lajmëruar se nuk është bërë zgjedhja e kandidatit nga ana e ministrit dhe në përputhje me nenin 108 paragrafi 5 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore, i emëruar ka qenë personi në cilës të UD drejtor organizativ për Shkup.

- Parashtruesi i denoncimit, mendon se kjo mѐnyrѐ e lajmѐrimit ѐshtѐ joligjore dhe nѐ kundѐrshtim me nenin 108 paragrafi 3 nga Ligji pѐr mbrojtje shѐndetѐsore sipas tѐ cilѐs "Ministri i shѐndetѐsisѐ nѐ afat prej 30 ditѐ nga dita e dorѐzimit tѐ dokumentacionit nga paragrafi 2 tѐ kѐtij neni merr vendim pѐr emѐrim tѐ drejtorit".
- I pakѐnaqur nga kjo mѐnyrѐ e informimit, parashtruesi e dѐrgon kѐtѐ ankesѐ deri te KSHPK dhe gjatѐ asaj nѐ mѐnyrѐ kronologjike informon se: Kѐshilli administrativ i ISHP KU pѐr Shkup, me Vendim nr / me datѐ 30.08.2019 vendosi tѐ shpallѐ konkurs publik pѐr zgjedhje tѐ drejtorit organizativ tѐ Institucionit tѐ shѐndetѐsisѐ publike Klinika Universitare pѐr Shkup; konkursi publik pѐr zgjedhje tѐ drejtortit organizativ tѐ Institucionit tѐ shѐndetѐsisѐ publike Klinika Universitare pѐr Shkup ѐshtѐ shpallur me datѐ 02.09.2019 nѐ mediat e shtypura "Koha", "Sloboden peѐat" dhe "Nova Makedonija"; Me datѐ 16.09.2019, ai u paraqit pѐr konkursin publik tѐ lѐndѐs si kandidat pѐr dejtor organizativ tѐ Institucionit tѐ shѐndetѐsisѐ publike Klinika Universitare pѐr Shkup; me datѐ 20.09.2019 dokumentacioni i plotѐ pѐr zgjedhje tѐ drejtorit organizativ tѐ Institucionit tѐ shѐndetѐsis publike Klinika Universitare pѐr Shkup ѐshtѐ dorѐzuar deri tek arkiva e Ministrisѐ sѐ shѐndetѐsisѐ sѐ RMV, kurse me datѐ 16.01.2020 ѐshtѐ miratuar Lajmѐrimi joligjor i pѐrmendur mѐ sipѐr nga ministri pѐr shѐndetѐsi nѐ RMV.
- Parashtruesi kѐrkon t'i aptovohet ankesa dhe gjatѐ asaj:
 - o 1. Tѐ anulohet Nѐ TѐRѐSI lajmѐrimi i sipѐrshѐnuar nr. / me datѐ 12.01.2020, miratuar nga ana e ministrit tѐ shѐndetѐsisѐ sѐ RMV, pѐr arsye se nѐ pѐrputhje me normativat pozitive ligjore, nѐse procedura pѐr shpallje tѐ konkursit publik ka mangѐsi dhe/ose nѐse tѐ gjithѐ kandidatѐ nuk posedojnѐ dokumentacion tѐ plotѐ ose nѐse nuk ѐshtѐ paraqitur asnjѐ kandidat pѐr konkursin, nѐ asi rasti ministri i shѐndetѐsisѐ mund tѐ emѐron UD. Nѐ tѐ kundѐrtѐn ministri ka qenѐ i obliguar tѐ zgjedh njѐ nga kandidatѐt e paraqitur nѐ konkursin e shpallur pѐr drejtor organizativ nѐ Institucionin e shѐndetѐsis publike Klinika Universitare pѐr Shkup.
 - o 2. Ai tѐ emѐrohet/zgjedhet/ i punѐsuar me Vendim nga Ministria e shѐndetѐsisѐ nѐ RMV pѐr drejtor organizativ nѐ Institucionin shѐndetѐsis publike Klinika Universitare pѐr Shkup nѐ pѐrputhje me normativat pozitive ligjore, gjegjѐsisht 30 ditѐ nga dita e dorѐzimit tѐ dokumentaciont tѐ kandidatѐve tѐ paraqitur deri nѐ Ministrinѐ e shѐndetѐsisѐ sѐ RMV , pѐr arsye se nѐ pѐrputhje tѐ procesverbalit nga komisioni i konkursit pѐr zgjedhje tѐ drejtorit organizativ tѐ Institucionin tѐ shѐndetѐsisѐ publike Klinika Universitare pѐr Shkup, ai ka qenѐ kandidat i vetѐm me dokumentacion tѐ plotѐ nѐ kѐtѐ konkurs publik.
 - o 3. Propozon qѐ KSHPK gjatѐ veprimit tѐ vet kompetent pѐr rastin e lѐndѐs, ta vlerѐson edhe momentin e dorѐzimit tѐ lajmѐrimit tѐ sipѐrshѐnuar pѐr emѐrim tѐ ushtruesit tѐ detyrѐs sѐ personit, i cili nuk vjen nga rradhѐt e tѐ punѐsuarve nѐ ISHP KU pѐr Shkup, nѐ periudhѐn e funksionimit tѐ Qeverisѐ teknike (nga data 03.01.2020) nѐ kuptim tѐ dispozitave tѐ vlevshme nga Kodi zgjedhir, si dhe rregullat pozitive me tѐ cilat ministri i shѐndetѐsisѐ nuk ka tѐ drejtѐ nѐ kѐtѐ periudhѐ tѐ emѐron ushtrues detyre nѐ ISHP KU pѐr Shkup

Në shtesë të denoncimit, është dorëzuar edhe dokumentacioni vijues: fletëdërgesë me datë 17.01.2020, lajmërim me nr. .../. me datë 16.01.2020 miratuar nga ana e ministrit të shëndetësisë së RMV dhe fletëparaqitje për konkurs publik me datë 16.09.2019, me të cilën ai është paraqitur në konkursin publik të lëndës.

- Gjatë kontrollimeve të bëra në web-faqen e KSHPK – baza e të dhënave për të gjithë personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë - REGJISTRI I PERSONAVE TË ZGJEDHUR/TË EMËRUAR, është konstatuar se për UD Drejtor në ISHP KU për Shkup është emëruar personi , me datë të emërimit 16.01.2020. Vendimi për emërim ushtrues detyre në USHP KU për Shkup, në rastin e lëndës është miratuar në përputhje me nenin 108 paragrafi 5 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
- Në denoncimin e dorëzuar nuk ka informacione se vallë nga ana e parashtruesit, si kandidat i paknaqur në procedurën, është shfrytëzuar e drejta me të cilën udhëzohet në vetë lajmërimin gjegjësisht, se ai ka afat prej 8 ditë nga pranimi i lajmërimit të lëndës paraqitje të mosmarrveshjes administrative për të njëjtën, në përputhje me nenin 108 paragrafi 4 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
- Me datë 02.09.2020, me kërkesë së KSHPK është dorëzuar informim nga ana e Ministrisë së shëndetësisë, me shtojcë dokumentacion, me të cilën informojnë se:
 - o ISHP Klinika universitare për Shkup, pas marrjes së Vendimit nga këshilli administrativ i institucionit, ka shpallur konkurs publik për zgjedhje të drejtorit organizativ, shpallur në gazetën ditore "Nova Makedonija", "Sloboden pečat" dhe "Koha" me datë 02.09.2019. komisioni i konkursit të ISHP Klinika universitare për Shkup, me shkresë deri te Ministria e shëndetësisë e dorëzoi dokumentacionin e plot të ISHP Klinika universitare për Shkup, me shkresë deri te Ministria e shëndetësisë e dorëzoi dokumentacionin e plotë për konkursin e shpallur për zgjedhje të drejtorit organizativ të ISHP Klinika universitare për Shkup. Grupi punues i cili është formuar nga ministri i shëndetësisë për kontrollim të dokumentave të dorëzuara nga kandidatët e paraqitur për konkursin e shpallur për zgjedhje/emërim të drejtorit/drejtor medicinal/drejtor organizativ në institucionet e shëndetit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pas mbledhjes së mbajtur dhe në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, në procesverbalin nr. .../. me datë 02.10.2019 është konstatuar se në afatin e caktuar prej 15 ditë nga shpallja e konkursit publik në shtypin ditor janë paraqitur gjithsej një kandidat:, i cili i ka dorëzuar dokumentat e kërkuara.
 - o Ministri i shëndetësisë, pas shpalljes së konkursit publik për zgjedhje/emërim të drejtorit organizativ në ISHP Klinika universitare për Shkup dhe procedurës së realizuar nga ana e komisionit të konkursit nuk ka bërë zgjedhje të kandidatit për drejtor organizativ edhe pse në konkurs është paraqitur një kandidat, me arsyje që kandidati i vetëm i cili është paraqitur në konkursin e shpallur për emërim të drejtorit, përveç dokumentacionit të dorëzuar në rregull, ka dorëzuar edhe programë të punës për institucionin e cila sipas mendimit të ministrit ka qenë me përmbajtje të paknaqshme.

Në përputhje me nenin 108 paragrafi 5 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore, nëse pas shpalljes së konkursit nuk emërohet drejtor, ministri i shëndetësisë në afat prej 5 ditë emëron ushtrues detyre drejtor deri në emërimin e drejtorit pas shpalljes së konkursit, por jo për më shumë se gjashtë muaj. Përshkak të kësaj, ministri për shëndetësi pas përfundimit të konkursit dhe procedurës së realizuar, në përputhje me nenin 108 paragrafi 5 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore, personi është emëruar për ushtrues detyre të drejtortit organizativ në ISHP Klinika universitare për Shkup.

- Ministri për shëndetësi në përputhje me nenin 108 paragrafi 4 nga ligji për mbrojtje shëndetësore me shkresë/lajmërim nr. me datë 16.01.2020 e ka lajmëruar kandidatin për drejtor organizativ duke theksuar se në këtë lajmërim për të drejtë kandidati i pakënaqur të ngritë mosmarrveshje administrative.
- Kandidati i pakënaqur nga lajmërimi i dorëzuar, me padi ka ngritë mosmarrveshje administrative para Gjykatës administrative, në të cilën Ministria e Shëndetësisë ka dorëzuar përgjigje për padinë nr. dhe me datë 18.03.2020 dhe e cila procedura para Gjykatës administrative ende është në rrjedhë.
- Personi i emëruar si ushtrues detyre të drejtorit organizativ të ISHP Klinika universitare për Shkup, edhe mëtej ka ushtruar këtë detyrë, kurse për përputhje me dispozitat ligjore Këshilli administrativ në institucionin e lëndës ka për obligim për miratim të vendimit për shpallje të konkursit publik për zgjedhje/emërim të drejtorit të institucionit, tre muaj para mbarimit të mandatit të drejtorit ekzistues. Mirëpo, duke pasë parasysh gjendje e tërësishme në RMV (vendimi i miratuar për shpallje të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, miratimi i dekretit me fuqi ligjore me të cilën ndërpritet të gjitha veprimet për realizim të zgjedhjeve, shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në RMV përshkak të pandemisë së Virusit Korona COVID-19, përfundimi i gjendjes së jashtëzakonshme) si dhe detyrimi për respektim të dispozitave të Kodit zgjedhor (neni 8-a dhe 8-b) të cilët kanë të bëjnë me kufizimin dhe ndalesat për ndërmarrje të aktiviteteve të caktuara në periudhën zgjedhore. Këshilli administrativ i Institucionit të shëndeti publik Klinika universitare për Shkup, nuk ishte dhe për shkak të mungesë së zgjedhjes së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në momentin e dorëzimit të përgjigjes deri te KSHPK dhe edhe më tej nuk ka qenë në gjendje të shpallë konkurs publik për zgjedhje/emërim të drejtorit organizativ të institucionit.

Në lidhje me gjendjen faktike të caktuar më sipër, KSHPK konstatoi se rasti i lëndës nga ana e parashtruesit të denoncimit është shfrytëzuar e drejta e tij ligjore në procedurë dhe ai me padi ka ngritë mosmarrveshje administrative në të cilën Ministria e shëndetësisë dorëzoi përgjigje për padinë dhe e cila procedura edhe më tej vazhdon pran Gjykatës administrative të RMV, që don të thot se për rastin vepron organ tjetër kompetent. Duke pasë parasysh të konstatuarën më sipër, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasē parasyshtē tē theksuarēn mē sipēr, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit vendosi si me dispozitat e kētij vendimi.

Љshtē vendosur me datē 29 dhjetor 2020, me numēr 12-905/4

Dorēzuar deri tek: Arkiva dhe parashtruesi

Pas pērfundimit tē KSHPK;

Punoi: J. C., Kēshilltarē

Miratoi: B. I., anētarē i KSHPK

KOMISIONI SHTETЉRORE PЉR
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Zēvendēs-kryetarē: Sofka Pejovska Dojēinovska

